

ABSTRAKT

Shqyrtimi fillestar i aktakuzës në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës

2018-2022

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës vëmendje të theksuar i ka kushtuar shqyrtimit fillestar. Ky shqyrtim, e bën procedurën penale të jetë me efikase, pasi menjëherë pas ngritjes së aktakuzës në shqyrtimin fillestar, në rastet kur i pandehuri e pranon fajësinë, procesi gjyqësorë mund të përmbyllet në këtë seancë me shqiptimin e dënimit nga gjyqtari i vetëm gjykues ose nga kryetari i trupit gjykues. Duke e ditur se shqyrtimi fillestar mbahet menjëherë pas ngritjes së aktakuzës, ligjvënësi ka paraparë me saktësi dhe në detaje si mbahet shqyrtimi fillestar, pranimi i fajësisë nga i pandehuri, kundërshtimi i provave, kërkesa për hudhje të aktakuzës, hudhja e aktakuzës, ndryshimi i aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe detaje tjera që do trajtohen gjatë këtij punimi.

Aktet akuzuese në të cilën bënë pjesë edhe aktakuza janë ai lloj i parashtrësive përmes të cilave organi i procedurës penale shkakton zanafillën, zhvillimin dhe përfundimin e çështjes penale, gjegjësisht përmes të cilave vihet në lëvizje procedura penale dhe ndikohet në rrjedhën dhe përfundimin e saj. Aktakuza është akt akuzues ose procedural të cilin mund ta paraqet prokurori i shtetit. Për shkak të peshës që ka aktakuza, Kodi i Procedurës Penale i ka kushtuar vëmendje të posaçme. Në këtë aspekt, ky Kod në mënyrë të veçantë, përpunon çështjen e përmbajtjes së saj dhe modalitetet të cilat i referohen mënyrës së procedimit të saj në gjykatë dhe çështjet e tjera që e karakterizojë atë. Ngritja e aktakuzës kundër të pandehuri dhe procedimi penal sipas saj është jo e këndëshme për të pandehurin edhe në rastet kur procedura përfundon me lirimin e tij.

Prandaj ligjdhënësi ka paraparë kontrollin e aktakuzës në seancën fillestare të shqyrtimit të aktakuzës në mënyrë që të pengohet nxjerrja e tij në shqyrtim gjyqësorë pa bazë të mjaftueshme. Ana tjetër pozitive e seancës për shqyrtim të aktakuzës manifestohet gjithashtu në ruajtjen e autoritet të organeve shtetërore i cili çënohet nëse në gjykatë arrin numër i madh i aktakuzave të pabazuara. Në seancën e shqyrtimit fillestar si rregull i bëhet një vlerësim paraprak ligjshmëris së aktakuzës por edhe i rrethanave tjera që i kanë paraprirë ngritjes së saj ku marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij pa të cilët edhe nuk mund të mbahet seanca gjyqësore.

Arsyeja e trajtimit të shqyrtimit fillestar sipas Procedurës Penale është sepse gjykatat e ndryshme të Kosovës kanë pasur qasje të ndryshme të zbatimit të këtij Instituti sa i përket shqyrtimit të aktakuzës. Duke e ditur rëndësinë e këtij punimi jam munduar që sa më mirë dhe sa më thjeshtë ta sqaroj tërë materien në mënyrë që të jetë sa më e kuptueshëm dhe sa më e kapshme për të gjithë dhe që të arrijë që sado pak të shqyrtoj këtë temë.

Zbatimi i dispozitave që parasheh Kodi i Procedurës Penale për mbajtjen e shqyrtimit fillestar paraqet interes të studimit në fushën e procedurës penale andaj si qëllim të studimit të kësaj teme është elaburimi më i detajuar për të kuptuar se ç'është aktakuza, si ngritet aktakuza, përmbajtja e saj, shqyrtimi fillestar që i bëhet aktakuzës, marrja e vendimit dhe ankesa kundër vendimit të marrur nga ana e gjykatës lidhur me aktakuzën që bëhet për vepra penale dhe të bëhet një vështrim më i detajuar për shqyrtimin e aktakuzës në përgjithësi për rastet penale në gjykata në territorin e Republikës së Kosovës e në veqanti për Gjykatën Themelore në Prishtinë ku bëhet një vështrim krahasues statistikore lidhur me rastet penale gjatë viteve 2018-2022. Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i kësaj teme, duke u mbështetur në aspektin teorik, ligjor dhe praktik, pasi që nuk është trajtuar shumë dhe si i tillë ky punim synon studimin e fazës së ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit.

Poashtu bëhet edhe një shqyrtim më i detajuar i aktakuzës, subjektet pjesmarrëse, detyrimet e gjyqtarit të vetëm ose kryetarit të trupit gjykues në raport me të pandehurin me të filluar shqyrtimi fillestar, veprimet pasuese të gjyqtarit, dhënja e fjalës së të pandehurit, prezantimi i marrëveshjes për pranimin e fajësis, kundërshtimi ndaj provave, kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe veprimet e tjera që e karakterizojnë shqyrtimin fillestar të aktakuzës.

Kurse në pjesën më të rëndësishme të punimit flitet për shqyrtimin fillestar të aktakuzës, numrin dhe dinamikat e çështjeve penale të trajtuara përmes shqyrtimit fillestar, numrin e aktakuzave të ngritura dhe se kush i ka paraqitur ato aktakuza, numrin e të akuzuarve sipas gjinisë dhe nacionaliteti, numrin e personave madhor të dënuar për vepra penale sipas gjinisë dhe nacionalitetit të tyre në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës 2018-2022.

Fjalët kyçe: Aktakuza, shqyrtimi fillestar, i pandehuri, gjykata, vepra penale, provat, fakte, rrethanat, marrja e vendimit, ankesa.

Mentori:

Prof. Dr. Azem Hajdari

Kandidatja:

Teuta Ahmeti

ABSTRACT

Initial review of the indictment at the Pristina Basic Court during the period 2018-2022

The Code of Criminal Procedure of the Republic of Kosovo has paid special attention to the initial examination. This review makes the criminal procedure more efficient, as immediately after the indictment is filed in the initial review, in cases where the defendant pleads guilty, the judicial process can be concluded in this session with the sentencing by the sole trial judge or by the president of the court. Knowing that the initial examination is held immediately after the filing of the indictment, the legislator has accurately and in detail foreseen how the initial examination is held, the admission of guilt by the defendant, the rebuttal of the evidence, the request to dismiss the indictment, the dismissal of the indictment, the amendment of the indictment from the state prosecutor and other details that will be dealt with during this paper.

The accusatory acts, which also included the indictment, are the type of submissions through which the criminal procedure body causes the genesis, development and termination of the criminal case, that is, through which the criminal procedure is set in motion and affects its course and termination. The indictment is an accusatory or procedural document that can be presented by the state prosecutor. Due to the weight of the indictment, the Code of Criminal Procedure has paid special attention to it. In this aspect, this Code in a special way, processes the issue of its content and the modalities that refer to its procedure in court and other issues that characterize it. The filing of the indictment against the defendant and the criminal proceeding according to it is not favorable for the defendant even in cases where the procedure ends with his release.

Therefore, the legislator has foreseen the control of the indictment in the initial hearing of the indictment in order to prevent it from being brought to judicial review without sufficient grounds. The other positive side of the session for reviewing the indictment is also manifested in the preservation of the authority of state bodies, which is undermined if a large number of unfounded indictments reach the court. In the initial review session, as a rule, a preliminary assessment is made of the legality of the indictment but also of other circumstances that preceded its filing, where the state prosecutor, the defendant and his defense participate, without whom the court session cannot be held. The reason for handling the initial examination according to the Criminal Procedure is

because the different courts of Kosovo have had different approaches to the implementation of this Institute regarding the examination of the indictment. Knowing the importance of this paper, I have tried to clarify the whole matter as best and as simply as possible, so that it is as understandable and as possible for everyone and that it will allow me to examine this topic even a little.

The application of the provisions provided by the Code of Criminal Procedure for holding the initial examination is of interest to the study in the field of criminal procedure, therefore the purpose of the study of this topic is the most detailed elaboration to understand what the indictment is, how the indictment is filed, the content of it, the initial review of the indictment, the decision making and the appeal against the decision taken by the court regarding the indictment for criminal offenses and to take a more detailed look at the review of the indictment in general for criminal cases in the courts in the territory of the Republic of Kosovo and especially for the Basic Court in Pristina, where a comparative statistical review is made regarding criminal cases during the years 2018-2022. The purpose of this paper is to deal with this topic, relying on the theoretical, legal and practical aspect, since it has not been dealt with much and as such this paper aims to study the phase of indictment and declaration.

There is also a more detailed examination of the indictment, the participating entities, the obligations of the single judge or the president of the trial body in relation to the defendant when the initial examination has begun, the subsequent actions of the judge, the giving of the defendant's word, the presentation of the agreement for the admission of guilt, opposition to the evidence, the request to drop the indictment and other actions that characterize the initial examination of the indictment.

While the most important part of the paper talks about the initial review of the indictment, the number and dynamics of criminal cases handled through the initial review, the number of indictments filed and who filed those indictments, the number of accused by gender and nationality, the number of adults convicted of criminal offenses according to their gender and nationality in the Basic Court of Pristina during the period 2018-2022.

Keywords: Indictment, initial review, defendant, court, criminal offence, evidence, facts, circumstances, decision making, complaint.

Mentor:

Prof. Dr. AzemHajdari

Candidate:

Teuta Ahmeti